

|               |                                                                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Për:</b>   | <b>Operatorë Ekonomik: Model group SHPK me adresë në Obiliq</b><br><br><b>Operatorëve Ekonomik</b><br><br><b>Të gjitha palëve të interesuar</b> |
| <b>Nga:</b>   | <b>Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit</b>                                                                                         |
| <b>Lënda:</b> | <b>VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës</b>                                                                                                        |
| <b>Datë:</b>  | <b>11.05.2023</b>                                                                                                                               |

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **10.05.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Model group SHPK**, me adresë në **Obiliq**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**, nxjerr:

### VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Model group SHPK**, me adresë në **Obiliq**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **21.03.2023**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Model group SHPK**, me adresë në **Obiliq**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **21.03.2023**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **10.05.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### **BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS**

#### **PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:**

Ju edhe pas nje letre standarde per mostra keni konfirmuar se duhet te sillen ato para hapjes, por marre parasysh naturen e paisjeve te pozicioneve, mendojme se nuk eshte e nevojshme, psh sjellja e pozicioneve 45.46 dhe 47 -klimave, secila nga klimat i kane nda dy pjese, pjesa e jashtme montuese dhe pjesa e brendshme. perveq qe jane te rende, sjellja e tyre per vlersim te tenderit nuk i ndihmon asgje komisionit sepse ato edhe ashtu nuk jane funksionale pa u montuar, nese komisioni eshte i interesuar te dije se si duken ka mundur te kerkohen katalogu ose specifikat e tyre me broshura, ky shihet qarte funksionaliteti i tyre, per me teper tenderi vleresohet ne baze te cmimit me te lire dhe nuk ka kriteret te percaktuara ne dosje qe vlereson nje model me shume se nje tjetër. Kerkojme analizimin e ketij kriteri dhe korigjimin e procedures.

---

#### **PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:**

**Sa i përket pretendimit Ankimore me Nr. 1 përkatësisht kërkesave për sjelljen e mostrave të pozicioneve të caktuara AK konsideron se ky pretendim nuk qëndron:**

Ne si Autoritet Kontraktues kemi konsideruar se Mostrat janë të nevojshme dhe gjithashtu kërkimin e mostrave e lejon edhe neni 37 Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik i cili nuk përcakton se deri në çfarë peshe duhet të jenë mostrat që mund të kërkojnë nga Autoriteti Kontraktues.

#### **PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:**

2. Po ashtu Dëshmia e kerkuar per pikat: **Dëshmia 2**

**Për kërkesat (2.1; 2.2; 2.3; 2.4; 2.5; 2.6;)**

• **Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit; nuk është e qarte qfare lemia duhet te kete reference ingjineri, lemin e studimeve si arkitekt apo ndertimtar apo lemin e mirmbajtjeve teknike te ndertesave.**

**Kerkojme qe kjo kerkese ose te largohet ose te kerkohet reference per lemin e studimeve te tij.**

---

## **PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:**

### **Sa i përket pretendimit Ankimore me Nr. 2 përkatësisht Dëshmime të kërkesave**

- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar për të cilën pretendoni se nuk është e qarte çfarë lëmie duhet të ketë reference gjithashtu nuk qëndron:

Dëshmitë mbi kërkesat (2.1; 2.2; 2.3; 2.4; 2.5; 2.6;) mjaft të qarta ngase AK ka kërkuar dëshmi

**(letër referencë)** për punët e më parshme varësisht nga stafi profesional i kërkuar p.sh.: (për inxhinier të ndërtimtarisë letër referencë për punën e më parshme si inxhinier i ndërtimtarisë, për arkitekt për punën e më parshme si arkitekt).

## **PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:**

**3. Kërkojmë analizimin e kriterit të sjelljes së dy salduesve të certifikuar kur dihet që projekti nuk ka ndonjë nature të nderlikuar, montimin e tyre mund ta bëjë staf me përvorje dhe sipas kërkesave të dosjes.**

---

## **PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:**

**Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar,**

Ndërsa Sa i përket pretendimit Ankimore me Nr. 3 në lidhje me kërkesën mbi 2 punëtor si saldues gjithashtu nuk qëndron.

Autoriteti kontraktues ka kërkuar për Lot 1 dy saldues ngase i njëjti Lot ka shumë pozicione, për mbulimin dhe kryerjen e punëve të të cilëve sipas AK nevojiten së paku dy saldues.

**Siç ju e dini, Autoriteti Kontraktues duke u bazuar në kërkesën tuaj për rishqyrtim të parashtruar me datë : 27.04.2023, ka bërë korrigjimet në të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ana juaj, ngase kërkesa juaj e parashtruar në datën e lartë përmendur ka qenë e arsyeshme. Ndërsa në kërkesën e parashtruar me datë 10.05.2023 kanë dalë pretendime ankimore të reja dhe nuk janë bazuar në asnjë nen të LPP-ës ose/edhe të Rregullave për Prokurim Publik.**

Bazuar në të dhënat e lartëcekur Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitave të këtij Vendimi. Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit  
Komuna e Rahovecit